

Fjala e Studentes Alumni znj. Merita Emini

I nderuar Rektor, Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku

I nderuar Kryeministër Z. Albin Kurti; kryetar i komunës z. Alban Hyseni

Të nderuar prorektorë, dekanë, profesorë, studentë, dhe të gjithë ju të pranishëm

Është nder i madh për mua të jem sot këtu, në mesin tuaj, në këtë ditë të paharrueshme. Të kthehem sot si alumni i Universitetit “Kadri Zeka” është një ndjenjë e veçantë – sepse çdo hap i rrugëtimit tim profesional dhe akademik lidhet ngushtë me këtë institucion.

Në vitin 2020 u regjistrova në këtë universitet, në Fakultetin e Shkencave Aplikative, në programin e Matematikës Arsimore. Atëherë kisha shumë dyshime. Nuk isha e sigurt nëse kisha zgjedhur rrugën e duhur, nëse do t’ia dilja me sukses. Por shumë shpejt kuptova se këtu nuk je kurrë vetëm. Profesorët e sidomos stafi menaxherial i fakultetit tonë ishin gjithmonë aty për të na mbështetur dhe për të na shtyrë përpara.

Dhe ja, duke studiuar matematikë, kuptova një të vërtetë: ndonjëherë zgjidhja nuk është e dukshme, ndonjëherë duhet të ndryshosh qasjen apo edhe të provosh metoda të reja. Si në matematikë, ashtu edhe në jetë, durimi, këmbëngulja dhe aftësia për të gjetur mënyra të reja janë çelësi i suksesit.

Ky universitet nuk më dha vetëm dije, por më dha besim. Më dha mbështetje përmes bursave, të cilat nuk ishin vetëm ndihmë financiare, por mesazh i qartë se përpjekja ime po vlerësohej. Më dha mundësinë të jem pjesë e jetës studentore aktive – si kryetare e këshillit studentor, ku mësova çfarë do të thotë të udhëheqësh dhe të jesh zëri i të tjerëve. Më dha hapësirë të jem pjesë e konferencave shkencore, ku pata fatin që në një prej tyre të jem moderuese e konferencës në gjuhën angleze.

Kur fillova studimet, nuk e mendoja kurrë se do të jem këtu sot, duke folur përpara jush si histori suksesi. Por e arrita – dhe kjo është dëshmia më e mirë se edhe ju mund ta bëni. Secili nga ju mund të ndërtojë një histori suksesi, nëse beson në veten dhe punon pa u lodhur.

Në vitin 2023 u diplomova nga ky universitet e sot kam përfunduar edhe studimet master dhe aktualisht punoj si profesoreshë e matematikës në gjimnazin “Zenel Hajdini” por krenaria më e madhe nuk është vetëm arritja ime, është fakti që këto arritje kanë lindur pikërisht këtu, në këtë universitet.

Të dashur studentë, e di që shumë prej jush sot jeni të gëzuar, por ndoshta keni edhe dyshime: çfarë do të ndodhë pas kësaj dite? A është kjo diplomë e mjaftueshme për të hapur dyert e së ardhmes? Meqë edhe vetë i kam pasë këto dyshime, ju them me bindjen më të madhe: PO! Ky universitet ju ka dhënë jo vetëm dije, por edhe besimin se mund t’ia dilni. Ju ka dhënë jo vetëm teori, por edhe aftësinë për t’i zbatuar ato. Ju ka dhënë profesorë që gjithmonë do ju mbështesin. Mbi të gjitha, ky universitet ju ka dhënë mbështetje në çdo hap – qoftë përmes bursave, aktiviteteve, apo mundësive për t’u zhvilluar si individë.

Prandaj, unë ju inkurajoj: mos lejoni që dyshimet t’ju ndalojnë. Merrni me vete mësimet, vlerat dhe eksperiencat që fituat këtu, dhe shfrytëzoheni çdo mundësi që ju vjen përpara. Mos kini frikë nga dështimi. Mos ndaloni së ëndërruari. Dhe mos harroni: kjo diplomë nuk është fundi. Është fillimi i një kapitulli të ri.

Ky universitet më dha shumë më tepër sesa një diplomë. Më dha besim, më dha guxim, më dha identitetin profesional që mbaj sot. Dhe jam e bindur se për secilin prej jush, ky institucion ka bërë të njëjtën gjë. Sepse në fund të ditës... ky universitet na bëri të jemi këta që jemi sot

Urime të gjithëve për këtë ditë të madhe! Dhe uroj që historia juaj e suksesit të nisë pikërisht nga ky moment.

Urime dhe suksese në rrugëtimin tuaj!

Ju faleminderit!